

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit MSc në “Menaxhim Biznesi”**  
**aplikuar nga Akademia Profesionale e Biznesit**

Eksperti i vlerësimit të jashtëm: Prof. Assoc Dr. Mimoza Manxhari



s

(Korrik, 2016)

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit MSc në “Menaxhim Biznesi” në APB, Tiranë.**

#### **HYRJJE**

Akademia Profesionale e Biznesit (APB) është institucion i arsimit të lartë që ofron të mira publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. APB ofron studime në ciklin e parë “Bachelor” dhe në ciklin e dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, si dhe kurse të tjera të specializuara afatshkurtra. APB funksionon në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Statutit, Rregulloreve dhe vendimeve të Senatit akademik dhe Këshillit të Administrimit. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 651 datë 14.09.2011 Akademia Profesionale e Biznesit është licencuar si institucion i arsimit të lartë. Me Urdhër nr.3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ky institucion është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit.

Akademia Profesionale e Biznesit, ka kërkuar, fillimin e procedurës për akreditimin e programeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi”. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me shkresën Nr.80 datë 29.02.2016 “Njoftim për vazhdimin e procedurës së vlerësimit” ka njoftuar zyrtarisht IAL APB, në kushtet që APB i ka përditësuar të gjitha të dhënat nëpërmjet sistemit të menaxhimit të APAAL dhe pas shqyrtimit në mbledhjen e këshillit të akreditimit datë 18.02.2016, për vijimin e procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit: “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”.

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:

1	IAL Aplikues:	Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhërin nr.277, datë 02.07.2012 i Ministrit Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim biznesi”
4	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi”
5	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (Dy) vjet
7	Kreditet në total (ECTS):	120
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-----
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-----

13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-----
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	Viti 2013-2015
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2013-2015

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof.Asc. Mimoza Manxhari

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

#### **Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor**

Programi "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" ka si qëllim studimin e kombinuar të metodave dhe formave bashkëkohore të menaxhimit, pajisjen e studentëve me njohuri rreth kontabilitetit, financës, menaxhimit dhe raportimit financiar, në funksion të përdorimit të këtyre dijeve në të gjitha nivelet e menaxhimit, në fushat e ekonomisë dhe biznesit. Programi është strukturuar për të edukuar studentët me njohuri në fushat e kontabilitetit, raportimit financiar, menaxhimit financiar, menaxhimit strategjik, menaxhimit operacional, ekonomiks i avancuar dhe kontabilitet drejtimi, standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe ato të auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, duke siguruar njohuri të cilat do t'i ndihmojnë ata të mendojnë në mënyrë analitike dhe kritike për zgjidhjen e problemeve të ndryshme ekonomike. Misioni i programit është përgatitja e individëve të kualifikuar për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jofitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor. Ky mision është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të IAL APB, me standardet ndërkombëtare, si edhe risitë që synon të sjellë ky institucion në arsimin e lartë.

Objektivat formues specifikë të programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" janë si më poshtë:

- Objektivat pedagogjikë: Objektivi kryesor i këtij programi studimi është pajisja e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e menaxhimit. Kurrikula dhe programet mësimore janë ndërtuar në përputhje me bazën e njohurive të përfituara në sistemin Bachelor 3-vjeçar në profilin: Administrim Biznesi, kërkesat e kartës së Bolonjës, zhvillimet e sektorit të biznesit në degë e sektorë të ndryshëm, në rang kombëtar e ndërkombëtar, etj., duke pasur si objektiv themelor thellimin dhe zgjerimin e tyre në drejtimet specifike të specialiteteve si menaxhimi dhe administrimi i bizneseve të shumë llojeve, financat dhe kontabiliteti i bizneseve, investimet dhe menaxhimi i kapitalit, tregjet dhe marketingu, njohuritë e avancuara në përdorimin e informatikës dhe informacionit, marrëdhëniet e bizneseve etj.

- Objektivat shkencorë: Përvetësimi nga ana e studentëve i njohurive themelore të shkencave të drejtimit dhe administrimit të bizneseve në nivel kombëtar, rajonal, ndërkombëtar. Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve duke kombinuar njohuritë e sintetizuara të eksperiencës në këto fusha me njohuritë e reja dhe debatin bashkëkohor. Zhvillimi i aftësive kërkuese e hulumtuese të studentët.

Në funksion të realizimit të misionit dhe të rolit që institucionet e arsimit të lartë, në tërësinë e tyre, duhet të luajnë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, programi u ka kushtuar një rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtëkurrikulare të studentëve, si: vizita në kompani të ndryshme, organizimi i leksioneve të hapura me figura të njohura të fushës, pjesëmarrje e studentëve në modele të ndryshme të forumeve ekonomike, pjesëmarrje në konkurse të biznesit, organizim dhe pjesëmarrje në konferenca studentore dhe shkencore në APB si dhe pjesëmarrje në debate tematike e televizive, tryeza të rrumbullakta etj.

### **Zhvillimi strategjik i programit të studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi"**

Zhvillimi strategjik i programit të studimit "Master i Shkencave" është konceptuar dhe funksionon në kuadër të strategjisë së zhvillimit institucional të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit". Në planin afatshkurtër APB synon konsolidimin e programit, si një program i rëndësishëm i ofruar nga institucioni dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, për ta bërë të krahasueshëm me programet më të mira të kësaj fushe në vend e më gjerë. Elementi kryesor i kësaj faze mbetet vlerësimi dhe analizimi me kujdes i të gjitha problematikave të konstatuara në vitet e para të ofrimit të programit, me qëllim përmirësimin e kurrikulës, reflektimin e inputeve të marra nga studentët, përmirësimin e planit mësimor, syllabuseve, etj.

### **Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit**

Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është hapur në vitin akademik 2012 - 2013, sipas Urdhërit Nr. 277, datë 02.07.2012 i Ministrit Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Menaxhim biznesi" pranë Akademisë Profesionale të Biznesit. Ky program zhvillohet me kohë të plotë, zgjat 2 vite akademike, në përfundim të të cilave studentët që plotësojnë kriteret përkatëse dhe numrin e krediteve 120 ECTS, sipas ligjit të arsimit të lartë dhe udhëzimeve të lëshuara nga MAS, si dhe pas nënshtrimit të provimit të Gjuhës së Huaj për marrjen e Certifikatës përkatëse, lëshohet diploma Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi". Pas përfundimit të programit, në sajë të njohurive të marra, studenti aftësohet për mundësinë e punësimit në njësitë e ndryshme ekonomike, kryesisht në sektorin e hartimit e të menaxhimit të strategjive dhe të vendimmarrjes e lidërshiptit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përftojnë studentët nëpërmjet tij u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike, nëpërmjet vazhdimit të studimeve të thelluara në doktoraturë, duke u mundësuar atyre zhvillimin dhe ngritjen në karrierë profesionale, shkencore dhe akademike.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”, i përgjigjet misionit dhe qëllimit të institucionit;</p> <p>Nga verifikimi dhe vlerësimi i situatës në IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”, rezulton se Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me nevojat që ka tregu i punës. Më specifikisht ky program synon një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor të individëve me përgatitjen dhe kualifikimin e nevojshëm për karrierë në sektorin privat dhe publik.</p> <p>Që në zanafillë të tij ky program ka pasur si parakusht mundësinë e punësimit të specialistëve të kualifikuar të fushës. Pikërisht programi i studimeve Msc në “Menaxhim Biznesi” synon të përgatisë specialistë të aftë të fushës së menaxhimit në përgjigje të plotë dhe menevojën e menaxhimit me cilësi dhe efikasitet të fondeve në bizneset e sotme.</p> <p>Programet e studimeve, ofruar nga IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”, ruajnë dhe promovojnë vlerat kulturore dhe traditën kombëtare.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”, është hapur në kuadër të implementimit të strategjisë së zhvillimit institucional të IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”. Në të materializohen ambiciet për zgjerimin dhe rritjen cilësore të këtij institucioni.</p>
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore</p>	<p>Programi i Studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”, ka në themel të tij kriteret e përcaktuara nga ligji Nr. 9741, date 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSH”, i ndryshuar dhe në mbështetje të udhëzimeve të Ministrit të Arsimit</p>

<p>dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>dhe Shkencës dhe Urdhërit Nr. 277, datë 02.07.2012 i Ministrit Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Biznesi” pranë Akademisë Profesionale të Biznesit.</p> <p>Emërtimet, përmbajtja dhe tërësia e dokumentacionit të siguruar për hapjen dhe licencimin e programit janë në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të këtij ligji. Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Kuadri Shqiptar i Kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” ka të hartuar dhe miratuar Planin Strategjik të Zhvillimit për periudhën 2015-2020,</p> <p>Institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni i cili adreson si zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve, ashtu edhe përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” është hartuar dhe zbatohet në përputhje me misionin e IAL dhe qëllimin e tij dhe synon potenciale të larta punësimi për studentët që diplomohen në të. Ky program është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” dhe me kërkesat e tregut të punës. Programi është në koherencë të plotë me kriteret e “Kartës së Bolonjës”, standardet institucionale dhe programe që aplikohen në tërë Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Programi zbatohet në përputhje me Planin e Zhvillimit Institucional si dhe me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Programi bazohet mbi profesionalizmin dhe përvojën pozitive, si edhe profilin që IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” ka krijuar në tregun kombëtar. Programi përcjell, përmes kurrikulës, trashëgiminë më të mirë, ruan vlerat kombëtare dhe konsideron fort arritjet bashkëkohore. Kjo u konstatua nga shqyrtimi i detajuar i dosjes me Programet e secilës lënde dhe dokumentacionin ku shprehet misioni dhe qëllimi i institucionit</p>	


**2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

### **Pjesa përshkrimore**

Fakulteti përgjegjës për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është Fakulteti i Ekonomisë. Në vitin akademik 2015-2016, secila prej njësive bazë ka në përbërje të saj të paktën 7 pedagogë efektivë, nga të cilët, të paktën 3 prej tyre, gëzojnë tituj ose grada shkencore. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se raporti i vlerësimit të brendshëm është i saktë dhe nuk ka ndryshime në treguesit e raportuar në lidhje me përbërjen e stafit efektiv dhe i plotëson standardet.

### **Tregues të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)



### **Autoritetet drejtuese:**

1. Dekani,
2. Përgjegjësi i njësisë bazë (Departamentit).

### **Organe drejtuese:**

1. Këshilli i Fakultetit
2. Departamenti

### **Vlerësimi sipas standardevë**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij konform Ligjit "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.</p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" është e organizuar në dy njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Ekonomisë</li> <li>2. Fakulteti i Drejtësisë</li> </ol> <p>Çdo njësi kryesore përbëhet nga 3 njësi bazë, nga të cilat dy departamente dhe një Qendër kërkimore;</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Menaxhimit</li> <li>2. Departamenti i Financë-Kontabilitetit</li> <li>3. Qendra Kërkimore-Shkencore</li> </ol> <p>Çdo njësi bazë përbëhet nga të paktën 7 anëtarë personeli akademik efektiv, prej të cilëve të paktën 3 gëzojnë tituj e grada shkencore, sipas përshkrimit mësipër.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore janë të vetëdijshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve. Fakulteti bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Autoritetet drejtuese të fakulteteve janë: Dekani, Përgjegjësi i Departamentit dhe Përgjegjësi i Qendrës kërkimore shkencore.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve për punësim në APB kryhet si rregull nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në plotësimin e kërkesave nga kandidatët për punësim. Pas identifikimit të nevojave për punësim, drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse paraqet pranë Rektorit dhe në njësinë organizative që mbulon burimet njerëzore, kërkesën për plotësimin e vendit të lirë të punës apo për punësimin e një punonjësi të përkohshëm jashtë strukturës së njësisë organizative dhe brenda numrit të</p>



	përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga Rektori.
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>Për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” njësia kryesore përgjegjëse është Fakulteti i Ekonomisë i IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”. Kjo njësi është organizuar konform përcaktimeve ligjore “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërje të tij 3 Departamente, me të paktën 7 pedagogë efektivë për çdo departament, nga të cilët të paktën 3 prej tyre gëzojnë tituj ose grada shkencore.</p> <p>Procedura e emërimit të stafit akademik të Fakultetit të Ekonomisë kryhet në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Rregullores të Marrëdhënive të Punës në IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”, përmes një procesi konkurrues që përfshin njësinë bazë dhe ato kryesore. Të gjitha proceset e rekrutimit dhe promovimit të stafit akademik bazohen mbi parimet e vlerave dhe meritokracisë.</p>	

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

Personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personeli akademik kryen veprimtari mësimore, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Personeli akademik gëzon liri akademike në punën e tij mësimore dhe kërkimore, në përputhje me aktivitetin dhe statusin që ka.

IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” nxit dhe mbështet lirinë akademike të stafit pedagogjik si dhe mundëson kualifikimin e mëtjshëm të tij, nëpërmjet: konferencave shkencore që organizohen nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit; botimit të artikujve shkencorë në Revistën “Scientific Journal of Professional Studies” (Revistë periodike botuar nga IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” me ISSN: 2412-5865 apo revista të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve që “Akademia Profesionale e Biznesit” disponon, etj. Titullarët e moduleve të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” janë personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë (raporti PAE/PAK në mbulimin e programit është mbi 70 %), ndërsa titullarët e moduleve të cilët janë me kontratë pune gëzojnë të paktën gradën shkencore “Doktor”. Personeli ndihmës mësimor - shkencor asiston personelin akademik në gjithë veprimtarinë e tij mësimore gjatë realizimit të planit mësimor të programit të studimit.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat lidhur me Numrin e Personelit Akademik Efektiv (PAE), Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, struktura didaktike për programin e studimit si dhe të dhënat e tjera që lidhen me personelin dhe që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm janë të sakta dhe sigurojnë

përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e programeve mësimore në nivelin e dytë “Mastër i Shkencave”

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik i IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” në vazhdimësi përfshihet në veprimtari mësimore dhe kërkim shkencor, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentë dhe detyra të tjera me karakter administrativ. Veprimtaria mësimore, kërkimore dhe administrative përcaktohet në kontratën e punës. Identiteti akademik i një pedagogu mbetet i lidhur me titullin dhe gradën shkencore që mban, si dhe me përgjegjësinë dhe aktivitetin shkencor që kryen e realizon përmes punës kërkimore dhe shkencore brenda institucionit, në përputhje me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të tij.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli ndihmës mësimor - shkencor asiston personelin akademik në gjithë veprimtarinë e tij mësimore gjatë realizimit të planit mësimor për çdo program studimi. Ky personel është në funksion të zhvillimit dhe arritjes së objektivave të programit të studimit. Personeli administrativ i IAL “Akademia Profesionale është personel i punësuar me kohë të plotë në institucion që ndihmon në realizimin sa më korrekt të planit mësimor në çdo program studimi. Objektivi i përbashkët në veprimtarinë e stafit akademik, ndihmës mësimor – shkencor dhe administrativ është realizimi i objektivave të programeve të studimit, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;  <b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Personeli akademik i Fakultetit Ekonomik është përgjegjës, nëpërmjet pjesëmarrjes në strukturat përkatëse vendimmarrëse kolegjiale të institucionit, në hartimin e kurrikulës dhe vendimarrjen sa u takon programeve të studimit. Rekrutimi i stafit akademik realizohet konform Statutit dhe Rregullores së Marrëdhënies të Punës të APB me procedurë të konkurrimit të hapur.

<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik realizohet konform Statutit dhe Rregullores së Marrëdhënieve të Punës të APB me procedurë të konkurrimit të hapur, duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” përbën më shumë se 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit;</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Administratori i IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik, në përfundim të procedurës së përshkruar më sipër. Kontrata e punës nënshkruhet në emër dhe për llogari të APB nga Administratori.</p>
<b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” gëzon gradën Doktor i Shkencave.</p> <p>Titullarët e moduleve të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” gëzojnë të paktën gradën shkencore Doktor, ndërsa lektorët diplomën Master i Shkencave dhe përvojë profesionale mbi 5 vjet dhe kryesisht janë në proces doktorature.</p> <p>Titullarët e moduleve të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi” janë personel akademik efektiv si dhe personel akademik me kontrate pune, të cilët gëzojnë të paktën gradën shkencore “Doktor.”Anëtarët e stafit akademik në këtë program studimi janë lektorë me kontribute të njohura në fushën e mësimdhënies dhe me eksperiencë të profilizuara sipas lëndëve apo moduleve dhe titullarë ciklesh leksionesh në</p>

2024

10/24

10/2/14

<p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>këtë program studimi.</p> <p>Në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” ka të punësuar me kohë të plotë (pedagogë efektivë), Rektoren dhe Zv/Rektoren, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Fakultetit të Drejtësisë, si dhe Përgjegjësit e Departamenteve përkatëse në këto Fakultete.</p> <p>Institucioni siguron personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale, në bazë të fushës së interesit që ka studenti. Lidhur me këtë proces Fakulteti i Ekonomisë disponon një paketë udhëzuese për të orientuar studentët që janë subjekt praktikash në të dy ciklet dhe për secilin program studimi që fakulteti ofron. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për realizimin e praktikave të studentëve. Sipas fushës dhe programit të studimit, studenti është orientuar, këshilluar dhe ndiqet nga afër për të realizuar me sukses praktikat mësimore në fusha dhe veprimtari specifike të këtij programi studimi.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Udhëheqësi i punës kërkimore të studentit ka një kualifikim të orientuar në fushën për të cilën do të udhëheqë punën kërkimore si dhe përgatitjen e tezës së diplomës.</p> <p>Udhëheqësi ka të paktën gradë shkencore “Doktor”.</p> <p>Udhëheqësi i punës kërkimore nuk mbikëqyr më shumë se 5 studentë njëkohësisht për punimet me karakter aplikativ dhe jo më shumë se 10 studentë njëkohësisht për tema në fushën e shkencave shoqërore dhe humane, duke respektuar kriteret e bazuara në standardet e L.A.L.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar</b></p>	

<p><b>Udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit që drejtojnë punën kërkimore të studentëve të cilët përfundojnë ciklin e dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”, kanë gradën shkencore “Doktor”, titujt akademikë “Prof. As. Dr.”, se “Profesor” dhe janë specializuar në fushën e ekonomisë, më specifikisht në administrim e menaxhim biznesi.</p> <p>Edhe kualifikimi i tyre shkencor është i orientuar në fushën e këtij programi studimi ose fusha të ngjashme me të. Ata janë autorë të cikleve të leksioneve, artikujve shkencorë apo monografish, konferenca e trajnime në këtë fushë studimi.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar, me kohë të plotë, personel ndihmës mësimor-shkencor, të kualifikuar, për realizimin optimal të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Biznesi”. IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” ka në dispozicion Laboratorin e informatikës</p> <p>Stafi akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ është i angazhuar plotësisht në përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Përcaktimi i ngarkesës mësimore të personelit akademik bëhet në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</li> <li>- Udhëzimin Nr. 20, datë 09.05.2008, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”;</li> <li>- Statutin e IAL “APB”</li> <li>- Kontratën individuale të punës të lidhur me IAL “APB”</li> </ul> <p>Veprimtaritë në të cilat angazhohet personeli akademik në IAL “APB” janë:</p> <p>a) mësimdhënie;</p>



	<p>b) kërkim shkencor;  c) aktivitete në mbështetje të programit mësimor;  d) praktika mësimore;  e) udhëheqje e temave të diplomës;  f) mbikqyrje për studentët;  g) mbështetje për institucionin;  h) punë administrative në funksion të programit të studimit</p> <p>Në procesin e mësimdhënies bëjnë pjesë: zhvillimi i leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratoreve, praktikave mësimore apo profesionale, si dhe veprimtari për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies: përgatitje individuale, zhvillim të kurrikulave, përtëritje të materialeve didaktike dhe hartim të materialeve të reja, modernizim të metodave dhe të procedurave të transmetimit e të kontrollit të dijeve, përgatitje të materialeve didaktike në veprimtari të mësimdhënies, provime, kontrole të pjeshme të dijeve, udhëheqje teze, udhëheqje të projekteve e detyrave, konsultime të programuara me studentët, etj.</p>
<p><b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" disponon dosjet e plota të pedagogëve efektivë dhe me kontratë, të cilët zhvillojnë aktivitet akademik në programet e ofruara nga APB.</p> <p>Zyra e administratës, e burimeve njerëzore dhe arkivit është përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore sipas rregullave dhe urdhrave të nxjerrë nga Senati akademik, si dhe për mbajtjen e arkivit të institucionit. Ndër detyrat kryesore të saj është mbajtja e të gjitha dosjeve të pedagogëve të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme; si dhe të arkivojë dhe të ruajë dokumentacionin e institucionit. Dosjet personale të punonjësve mbahen dhe administrohen nga njësi organizative që mbulon burimet njerëzore. IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" disponon listën e plotë të stafit akademik dhe administrativ të tij. Kjo listë përkon me programet e studimit të ofruara nga IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" në vitin përkatës akademik. Titullarët e moduleve dhe plani mësimor miratohen nga Senati Akademik i IAL "Akademia Profesionale e Biznesit".</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e</p>

procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe me dispozitat e Statutit dhe Rregullores së Marrëdhënieve të Punës në IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" . Punësimi i stafit akademik realizohet me procedurë konkurrimi të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Shpallja e procedurës për rekrutimin e stafit akademik afishohet në tabelën e njoftimeve të institucionit
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka të punësuar personel akademik të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, si dhe me aktivitet shkencor (autorë tekstesh, monografish, artikuj shkencor, etj.), në fushën ku orientohet programi i studimit. Personeli akademik është pjesë e hartimit të politikave të zhvillimit të institucionit dhe vendimmarrjes mbi elementët më të rëndësishëm të aktivitetit akademik, nëpërmjet organeve kolegjiale ku përfaqësohet.</p> <p>Institucioni përpiqet maksimalisht të respektojë standardet ligjore të raportit midis studentëve/pedagogeve dhe stafit administrativ dhe ndihmës. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Punësimi i stafit akademik realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur, duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p> <p>Personeli akademik 2015-2016 mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë e tij akademike dhe administrative. Personeli akademik efektiv mbulon të paktën 70 % të procesit mësimor në çdo program studimi.</p> <p>Angazhimi i stafit akademik të çdo kategorie në procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktivitete në mbështetje të programit mësimor, praktika mësimore, udhëheqje e temave të diplomës, tutoriat për studentët, mbështetje për institucionin, punë administrative në funksion të programit të studimit është konstant dhe i konceptuar si normë e veprimtarisë së përditshme.</p>	

#### 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

Institucioni i Arsimit të Lartë "Akademia Profesionale e Biznesit" e ushtron aktivitetin e saj mësimdhënës në adresën: Rr. "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë Tiranë, në një ambient unik, në një objekt i cili është funksional vetëm për aktivitetin e ushtruar nga ky institucion. Sipërfaqja e përgjithshme e ndertesës 4-katëshe, ku zhvillon veprimtarinë e saj APB dhe pjesës tjetër, ndertesa njëkatëshe ngjitur në krah të saj, si dhe ambjenti tjetër çlodhës dhe rekreativ për studentet është rreth 3000 m<sup>2</sup>. I gjithë objekti, tek i cili janë kryer investime edhe nga vetë APB, është i kontraktuar me qira, sipas e kontratës së qirasë me Nr. 5153 Rep. dhe Nr. 1711 Kol., datë 11.09.2014, me afat vlefshmërie deri më 11.09.2019, dhe me të drejten e rinovimit deri në vitin 2026.

Mjediset sikurse edhe të gjitha fasilitetet infrastrukture/logjistike janë në shërbim, në mënyrë të pandarë, për të dy njësitë kryesore të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit": Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë. Godina është moderne, e ndërtuar me materiale cilësore bashkëkohore, dhe është certifikuar zyrtarisht se plotëson të gjitha

kushtet teknike dhe ato higjieno-sanitare për ushtrimin e aktivitetit. Objekti është i ndarë në ambiente të ndryshme, në funksion të veprimtarisë së mësimdhënies, si më poshtë:

- a. Auditorë/Salla mësimi;
- b. Ambiente për personelin akademik;
- c. Ambiente për personelin administrativ;
- d. Ambiente për bibliotekën, për shërbime ndaj studentëve, senatin, sallë kompjuterash, multimedia, etj., të kësaj natyre;
- e. Ambiente Laboratorësh;
- f. Ambiente Internet – Kafe;
- g. Ambiente për Shërbimet Financiare dhe të Praktikës Profesionale për studentet;
- h. Arkivë, magazina;
- i. Ambiente teknike (të cilat i shërbejnë funksionimit të godinës si: motor gjenerator, Stabilizator tensioni, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike, etj.);
- j. Oborr;
- k. Lulishte;
- l. Parkim.

Fondi i bibliotekës, është i pasur, i krijuar mbi bazën e blerjeve të vazhdueshme dhe donacionet. Ky fond pasurohet në mënyrë të vazhdueshme. Institucioni shpenzon fonde të planifikuara për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në fushën e kërkimit shkencor. Përsa i përket teknologjisë, biblioteka është e pajisur me një sistem dokumentacioni dhe informacioni për një shërbim efektiv ndaj studentëve dhe pedagogëve. Sistemi i krijuar mundëson shkëmbimin e të dhënave me Bibliotekën Kombëtare, bibliotekat europiane, si dhe vendosjen e partneritetit me institucione brenda dhe jashtë vendit për shkëmbim e huazim të informacionit (abonime online). Biblioteka në funksion të azhurnimit të stafit akademik dhe studentëve publikon listën e hyrjeve të reja, listën e abonimeve vjetore dhe bibliografi selektive sipas tematikës. Për studentët çelet kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës, si dhe shërbim bibliotekar. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar. Çdo vit institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës. Këto nevoja përpilohen nga vetë pedagogët e lëndës dhe APB bën blerjen e tyre. Në mjediset e bibliotekës shërbehet nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8:30 deri 15:00 dhe nga ora 16:00 deri 19:00. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Biblioteka online është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare. Prej 3 vjetësh është siguruar aksesimi i stafit dhe studentëve në disa biblioteka elektronike të huaja. Disa nga këto adresa, të cilat janë funksionale për bibliotekën elektronike, janë:

<http://www.thefreelibrary.com>  
<http://www.gutenberg.org/>,  
[www.lawlink.coe.int](http://www.lawlink.coe.int);  
[www.lawlink.nsw.gov.au](http://www.lawlink.nsw.gov.au);  
[www.localjuris.com.fr](http://www.localjuris.com.fr);  
[www.accessmylibrary.com/](http://www.accessmylibrary.com/);  
[www.doaj.org](http://www.doaj.org)  
[www.ebsco.com](http://www.ebsco.com);

[www.cobis.al](http://www.cobis.al)  
[www.reatprint.com](http://www.reatprint.com)  
[www.freelebrary.com](http://www.freelebrary.com)

Në pasurimin e bibliotekës dhe promovimin e produktit shkencor të stafit akademik një rol të rëndësishëm ka luajtur, ndër vite, botimi i materialeve të trajtuara në Konferencat e përvitshme shkencore të Akademisë Profesionale të Biznesit në Proceedings, e cila destinohet për lexuesin e specializuar nëpërmjet botimit të studimeve shkencore në fushat e ekonomisë dhe drejtësisë. Përveç kësaj, vitin e kaluar ka filluar botohet një Revistë shkencore, Botimi i Akademisë Profesionale të Biznesit, “REVISTA SHKENCORE E STUDIMEVE PROFESIONALE”, me Bord Editorial dhe ISSN, që botohet 2 herë në vit. IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” publikon, dy herë në vit edhe periodikun e saj studentor “#APBMAG”. Këto botime, duket se po krijojnë një traditë të pëlqyeshme në lidhje me veprimtarinë botuese. Fondi i këtyre botimeve do të zgjerojë numrin e titujve në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë për APB, duke iu adresuar lexuesve të specializuar ose jo, me botime të studimeve kërkimore e shkencore në këto fusha. Sa u takon Laboratorëve, IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”, ofron për studentet Laboratorin e informatikës me 26 komplete kompjuterash (PC), të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop. Në to janë instaluar edhe Programe/Softe aplikative të Financës dhe Kontabilitetit (Financa 5, Alfa etj). Në këtë laborator punojnë studentët e të dy fakulteteve dhe të të dyja cikleve të studimit, në shërbim të Lëndeve/ Moduleve të “Bazat/ Hyrje në Informatikë” dhe Menaxhim i Sistemeve të Informacionit” (MSI), “Kontabiliteti i Aplikuar” etj. Përveç kësaj, studentët e APB, nga Ekspertë dhe Studio Profesionale të licencuara në Laborator mësojnë përdorimin e Softeve aplikative dhe për këtë pajisen me Certifikatat përkatëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat lidhur me mjediset për Programin e studimit dhe mjediset për stafin që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm janë të sakta dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e programeve mësimore në APB

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” e ushtron aktivitetin e saj mësimdhënës në një ambient unik, në një objekt i cili është funksional vetëm për aktivitetin e ushtruar nga ky institucion, dhe në përputhje me standardet që kërkon MAS për IAL.

<p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Objekti kryesor dhe ambientet e tjera disponohen nga institucioni, mbi bazën e kontratave së qirasë me Nr. 5153 Rep. dhe Nr. 1711 Kol., datë 11.09.2104, me afat vlefshmërie deri më 31.08.2026. Ndërkohë, “Akademia Profesionale e Biznesit” ka nënshkruar kontrata edhe për 230 m2, që është në përdorim, si dhe për rreth 1000 m2, që do të rikonstruktohen dhe do të hyjnë në fuqi në Tetor 2016 me fillimin e vitit të ri akademik.</p> <p>Veprimtaria për zbatimin e programit të studimit zhvillohet në një godinë permanente. Institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Me kapacitetet që ka krijuar dhe mjediset që ka në dispozicion, Akademia Profesionale e Biznesit, siguron për studentet e saj, realizimin e procesit mësimor dhe të praktikave profesionale apo të punëve në laborator të tyre, në nivelin më të mirë të mundshëm.</p>
<p><b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” vë në dispozicion të studentëve, nëpërmjet bibliotekës, tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit.</p> <p>Fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme.</p> <p>Biblioteka disponon një fond me libra që ndihmojnë studentët në realizimin me sukses të programit të studimit. Në bibliotekë sigurohet pjesa kryesore e teksteve mësimore dhe literaturës ndihmëse të programit, sikurse ofrohet edhe literaturë që s’ka lidhje specifike me programin por i përket së njëjtës fushë studimi.</p> <p>Synimi kryesor i IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” mbetet pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës, duke konsideruar se programet e studimit të Fakultetit Ekonomik dhe Juridik janë funksionale për një kohë relativisht të shkurtër – prej vitit 2011, si edhe garantimi</p>

<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>i aksesit të plotë për studentët dhe stafin akademik në më tepër librari elektronike shkencore të fushës ekonomike dhe juridike, për të ardhmen. Paralel, një pjesë e pedagogëve të lëndëve/moduleve përkatëse, kanë përgatitur dhe Tekste me "Cikël Leksionesh" të dedikuara për lëndën, dhe u jepen studentëve për përgatitjen më të mirë të tyre. Që nga hapja e programit është ofruar shërbimi i bibliotekave falas online dhe gjatë 2-3 viteve të fundit akademike. Mbetet të finalizohet kontrata e posaçme me librari elektronike dhe të realizohet abonimi i plotë vjetor për vitin e ri akademik.</p> <p>Përgjegjësi i programit të studimit depoziton planin e detajuar të teksteve mësimore dhe literaturës plotësuese në momentin e hapjes së programit. Mbi bazën e këtij plani është bërë, gradualisht, planifikimi i nevojshëm buxhetor nga administrata dhe pasurimi i bibliotekës. Biblioteka e IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" disponon një sërë botimesh periodike të lidhura me programin e studimit. Synimi mbetet zgjerimi i gamës së këtyre botimeve.</p> <p>Orari i bibliotekës i përgjigjet kohës kur studentët e programeve që ofron institucioni ndodhen aty. Oraret e bibliotekës gjenden të afishuara pranë mjediseve të institucionit.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" zotëron në sasi të mjaftueshme mjedise, salla, zyra, studio, laboratorë, të nevojshëm për realizimin e programit të studimit, sipas përkrahimit të bërë më sipër dhe specifikimeve në tabelat përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet</p>	<p>Mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 11, datë 28.2.2011 "Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës." Në funksion të realizimit të programit të studimit institucioni ofron infrastrukturë moderne mësimdhënieje, që përfshin pajisje elektronike dhe teknologjike në shërbim të nevojave të stafit dhe studentëve.</p> <p>Mjediset mësimore, në varësi të funksionit të tyre (auditorë, salla leksionesh, klasa seminaresh) janë të</p>

<p>e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>pajisura me të gjitha mjetet e përshtatshme për mësimdhënie, përfshirë: kompjutera, (Lap-Topë), videoprojektorë, lidhje interneti, etj. Pranë institucionit funksionojnë, në ndihmë të programeve të studimit, Laboratori i Informatikës me kapacitet prej 26 vëndesh dhe Laboratori (Studio) i Praktikës Profesionale për Financë dhe Kontabilitetin, me kapacitet prej 15 vëndesh; Zyra e Dhënies FALAS të Shërbimeve Juridike dhe të Avokatisë; komunitetit të zonës ku kryen aktivitetin e saj Akademia Profesionale e Biznesit. Për plotësimin më të mirë të nevojave të studentëve për kryerjen e Praktikave Profesionale, Akademia Profesionale e Biznesit, ka siguruar një rrjet të gjerë prej 43 Marrëveshjesh dypalëshe të nënshkruara me kompani, institucione dhe enteitate të ndryshme, publike dhe private. Ku përveç zbatimit të detyrimeve dypalëshe, APB dërgon pranë tyre studentët për të kryer praktikat mësimore dhe profesionale.</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Bazuar në verifikimin e të dhënave RVB dhe informimit nga takimet konkrete, konstatojmë IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e programeve si të ciklit të parë dhe atij të dytë të studimeve që ofron. Në dispozicion të studentëve dhe stafit mësimdhënës dhe ndihmës, ka mjedise mësimore që plotësojnë standardet teknike të kërkuara. Mjediset janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme bashkëkohore, që garanton zhvillimin me sukses të procesit të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Shtimi dhe zgjerimi i ambienteve të kryera dhe atyre që parashikohet të realizohen për vitin 2016-2017, pritet të përforcojë qëndrueshmërinë dhe të rrisë më tej cilësinë e infrastrukturës dhe logjistikës që mundëson mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe rritjen e kapacitetit dhe sigurisë së studenteve, për të dalë në tregun e punës me kapacitetin që kërkon tregun.

IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka një bibliotekë relativisht të pasur, të pajisur me literaturën e nevojshme, e cila garanton realizimin me sukses të programeve të studimit. Institucioni planifikon dhe alokon fondet e nevojshme për pasurimin e vazhdueshëm të fondit të bibliotekës.

Sfida e institucionit mbetet shtimi i Fondit të librave të saj me literaturë të fushës ekonomike dhe juridike, për t'u shërbyer më mirë nevojave të programeve të reja të studimit që ofrohen nga ky institucion në të dy ciklet e studimeve dhe në dy fakultetet e tij.

Rekomandojmë që, mundësisht brenda vitit akademik 2016-2017, institucioni të garantojë një kontratë të dedikuar për të drejtën e përdorimit në mënyrë të pandërprerë të bibliotekës elektronike.

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**Pjesa përshkrimore**

IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" sa i takon financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë dhe të shoqërive tregtare. Institucioni çdo vit, në mënyrë të rregullt, auditohet nga një ekspert kontabël i regjistruar. Sikurse pasqyrohet në tabelën e mëposhtme, pasqyrat financiare që i bashkëngjiten raportit, pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit, në vitet e fundit, vijnë nga tarifat e studimit që paguhen nga studentët. Për sa u përket kapaciteteve menaxhuese, "Bezo Consulting shpk" dhe "Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes" (ISAB) si entitete të të njëjtëve themelues, edhe të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", në bashkëpunim me njëra-tjetrën, bashkërendojnë çështjet financiare dhe menaxhuese.

Kostoja për student ka ardhur në ulje si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit të burimeve, rritjes së numrit të studentëve në vite dhe të njëjtës vlerë të qirasë vjetore që institucioni paguan, duke bërë që raporti kosto fikse/të ardhura të jetë në përpjestim të zhdrejtë. Sikurse është paraqitur edhe në tabelat e mësipërme, pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime që kanë lidhje me koston e punës (kryesisht pagesat e pedagogëve), si edhe qiranë. IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, ka përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme stafin pedagogjik, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe cilësore. Kjo gjë ka sjellë rritje të koston së punës në mënyrë progresive. Nga analiza financiare e kryer nga institucioni rezulton se të ardhurat mesatare për student për vitin akademik 2012-2013 janë 1100 Euro, ndërsa shpenzimet mesatare/student për këtë vit akademik janë 106 mijë lekë. Për vitin akademik 2013-2014 të ardhurat mesatare për student janë 1200 Euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student janë 102 mijë Lekë. Vitin e trete 2014-2015, të ardhurat për student janë 1250 Euro, shpenzimet mesatare janë 100 mijë lekë.

### **Kapacitetet menaxhuese financiare**

Burimet financiare të Akademisë Profesionale të Biznesit, sigurohen nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Ndërkohë, investitorët kanë financuar sa herë lind nevoja për situatat e krijuara për diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve, apo nevojave për të kryer investime, që sigurojnë standardet e nevojshme për realizimin e procesit mesimor në kushte sa më normale. Burime financiare shtesë Akademia Profesionale e Biznesit siguron edhe nepërmjet Sesioneve të Trajnimeve të përvitshme që ajo realizon me stafin dhe kapacitetet e Institutit për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), (krijuar nga APB dhe në mbështetje të saj), me Profesionistë të ndryshëm të Financës dhe Kontabilitetit, të cilët



përgatiten dhe japin provimet e shtetit për të fituar Titujt Profesionalë "Ekspert Kontabël i Autorizuar" (Auditues) dhe "Kontabilist i Miratuar". Së fundmi, janë duke u shtuar edhe burimet nga kontratat e siguruara për shërbime, studime dhe projekte të realizuara së bashku me palë të treta ose dhe vetë si institucion. Këto burime aktualisht kanë qenë modeste, por nënvizohet se ato po vijnë dhe do të vijnë duke u shtuar në të ardhmen, si rasti i Projektit për Ngritjen e Zyrës së Shërbimeve Juridike dhe të Avokatisë, për nevojat e komunitetit ku APB kryen aktivitetin e saj.

Akademia Profesionale e Biznesit siguron burimet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ajo trajton dhe motivon financiarisht në mënyrë të diferencuar personelin akademik efektiv dhe me kontratë sipas gradave dhe titujve shkencorë. Akademia Profesionale e Biznesit plotëson burimet financiare për fuqizimin e Bibliotekës me fonde të reja librash, mbështet nevojat për kërkimin shkencor dhe Konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështet botimin dhe publikimin e periodikëve të saj dhe të materialeve të konferencave shkencore, mbështet trajnimin në vazhdimësi të stafit akademik dhe atij ndihmës. Akademia Profesionale e Biznesit mbështet me bursa dhe me gjysmëbursa çdo vit rreth 40-50 studentë, me mesatare të lartë apo me probleme sociale dhe ekonomike, që në total arrijnë mbi 50-60 mijë euro në vit. Gjatë 5 viteve aktivitet IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka dëshmuar se ka kapacitete të mjaftueshme për ruajtjen e gjendjes optimale financiare dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat lidhur me financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm janë të sakta dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e programeve mësimore në APB.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Përmbushja e standardeve</b>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij.;	IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" realizon, nëpërmjet ekspertit kontabël të regjistruar (auditues), një auditim të jashtëm, të situatës financiare të tij. Audituesi kryen kontrollin dhe certifikimin e llogarive kontabël, pasqyrimin në

<p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj.;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>librat financiarë (libri i shitjeve, libri i blerjeve), shqyrton dhe vlerëson plotësimin e kërkesave sipas standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, zbatimin e legjislacionit tregtar dhe atë të sistemit të legjislacionit tatimor, mbështetur dhe në analizën e riskut.</p> <p>Në përfundim të procesit, pas verifikimit të dokumentacionit që lidhet me sistemin e Pagave të stafit akademik, të personelit administrativ dhe mbështetës, të Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shpenzimeve të tjera operative dhe detyrimeve të tjera financiare, hartohet</p> <p>Raporti i Auditit, i cili jep sigurinë e vërtetësisë së informacioneve të Pasqyrave Financiare të APB, i cili disponohet nga institucioni dhe njëkohësisht depozitohet pranë QKR-së konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.</p>
<p><b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b></p>	
<p><b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Për çdo vit kalendarik institucioni harton pasqyrat financiare konform standardeve të kontabilitetit dhe Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare."</p> <p>Në pasqyrat financiare janë të detajuara llogaritë e aktiveve dhe të detyrimeve, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra analitike e kapitalit, pasqyra e amortizimit të aktiveve për periudhën përkatëse. Aty identifikohen të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe nga burime të tjera, si ato, nga bashkëpunimet apo vetë si institucion për studime dhe projekte, nga Trajnime të ndryshme të profesionisteve apo stafeve të kompanive të ndryshme, si dhe drejtimit se ku janë kryer shpenzimet e institucionit.</p> <p>Këto Pasqyra Financiare miratohen nga Senati dhe Këshilli i Administrimit të "Akademisë Profesionale të Biznesit" dhe depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe organeve tatimore.</p> <p>Gjendja financiare e institucionit paraqitet e qëndrueshme, me kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar ecurinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës dhe procesit mësimor.</p>

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Bazuar në të dhënat e RVB dhe dokumentacionin e depozituar apo dhe informacionet verbale nga takimi në zyrën e financës, konstatojmë se Akademia Profesionale e Biznesit ka një sistem të plotë të rregjistrimit të të dhënave të reflektuar në dokumente financiare në konformitet të plotë me ligjin dhe standardet e kontabilitetit. Institucioni dokumenton rregullisht veprimtarinë nëpërmjet pasqyrave financiare vjetore dhe auditimit të jashtëm të përvitshëm të llogarive të tij nga ekspert kontabël i regjistruar (Auditues i pavarur). Akademia Profesionale e Biznesit siguron dhe alokon në kohë burimet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Ajo trajton dhe motivon financiarisht në mënyrë të diferencuar personelin akademik efektiv dhe me kontratë sipas gradave dhe titujve shkencorë.

Akademia Profesionale e Biznesit plotëson burimet financiare për fuqizimin e Bibliotekës me fonde të reja librash, mbështet nevojat për kërkimin shkencor dhe Konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështet botimin dhe publikimin e periodikëve të saj dhe të materialeve të konferencave shkencore, mbështet trajnimin në vazhdimësi të stafit akademik dhe atij ndihmës. Nën frymën e ligjit të ri të arsimit të lartë Akademia Profesionale e Biznesit po punon për diversifikimin e burimeve të financimit përmes aplikimit në projekte si dhe kan vendosur bashkëpunimit me biznesin.

Burimet financiare të Akademisë Profesionale të Biznesit paraqiten të qëndrueshme duke garantuar siguri në vijueshmërinë e çdo aktiviteti të saj.

**6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

**Pjesa përshkrimore**

Institucioni I Arsimit të Lartë "Akademia Profesionale e Biznesit" është konceptuar dhe funksion në përputhje me Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL-ESG/SUE). Sigurimi i cilësisë është i përqendruar mbi studentin në çdo aspekt të mësimdhënies dhe mësimnxënies, që nga përmbajtja e kursit dhe rezultatet e edukimit, te shërbimet mbështetëse e deri te punësimi, përfshirë edhe menaxhimin e institucionit. Sigurimi i cilësisë angazhon të gjithë aktorët e institucionit dhe merr parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, të gjithë palëve të interesit dhe shoqërisë.

Veprimtaria e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) rregullohet nga (Neni 16) i Statutit të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" dhe nga Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), e miratuar me Vendim Nr.5, datë 05.11.2014 të Senatit Akademik. Mekanizmi bazë me të cilin NjSBC realizon misionin dhe objektivat është vlerësimi i brendshëm i cilësisë, që është një proces i pandërprerë, me qëllim kryesor përmirësimin e kulturës së cilësisë brenda IAL-së. NjSBC në këtë proces periodik mbikëqyr, analizon dhe rekomandon rregullimet e nevojshme në drejtimet kryesore, sipas

përcaktimeve të Standardeve të cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, dhe që konsistojnë në:

- Hartimin dhe miratimin e programeve.
- Mësimnxënien, mësimdhënien dhe vlerësimin me studentin.
- Pranimin, progresin, njohjen dhe certifikimin e studentit.
- Stafin mësimdhënës.
- Burimet mësimore dhe mbështetjen e studentëve.
- Menaxhimin e informacionit.
- Informimin publik.

Aktualisht NjSBC është një strukturë me 5 anëtarë të miratuar sipas Vendimit të Senatit Nr 41, datë 16/10/2015.

#### Të dhëna sasiore për punën konkrete të NjSBC

Në përfundim të çdo semestri akademik, të gjithë studentët e IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" plotësojnë pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 3 (vlerësimi më i lartë), abstenim si dhe vlerësim me PO dhe JO. Plotësimi i pyetësorit bëhet në mënyrë krejtësisht konfidenciale. Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, NjSBC nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog me një shifër për çdo përbërës të pyetësorit. Pyetësori për vlerësimin e pedagogut përbën një nga indikatorët më të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së pedagogut. Rezultatet e pyetësorëve u përcillen organeve dhe autoriteteve drejtuese të institucionit që kryejnë analizimin e të dhënave dhe dalin me rekomandimet përkatëse.

Në aspektin e vlerësimit të jashtëm, Akademia Profesionale e Biznesit ka krijuar mundësinë që një subjekt i jashtëm, Qendra Kërkimore "Tirana Business Reserach Center", të organizonte gjatë vitit akademik 2014-2015 një pyetësor me pyetje kontrolli dhe pyetje faktike për studentët dhe një pyetësor me pyetje kontrolli dhe pyetje faktike për personelin e APB, me fokus "Matja e Cilësisë së Shërbimit në Akademinë Profesionale të Biznesit", me dy komponentë:

- 1- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit nga ana e studentëve dhe
- 2- Niveli i kënaqësisë së stafit akademik.

Sipas këtij studimi, pritshmëria e përgjithshme lidhur me cilësinë ishte në nivel 6.15 sipas Shkallës Likert nga 1 në 7 dhe perceptimi ishte në nivelin 5.63, duke treguar një diferencë vetëm 0.51 pikë, që tregon se studentët kanë vlerësuar kënaqësinë për zgjedhjen e APB në nivelin 6.34 dhe gjithashtu studentët vlerësuan në nivelin 6.34 dhe 6.42 rekomandimin që ata do të bëjnë për këtë IAL. Përmasat që ishin shumë të lidhura me kënaqësinë e studentëve ishin "**përgjigjshmëria**" dhe "**besueshmëria**". Pika që trajton "**mbajtjen e premtiveve**" është pika më e lidhur nga pyetjet sa i përket kënaqësisë së klientëve.

Sipas këtij studimi, lidhur me nivelin e kënaqësisë së stafit akademik del se pritshmëria e përgjithshme lidhur me cilësinë ishte në nivelin 6.06 sipas shkallës Likert 1 - 7 dhe perceptimi ishte në nivelin 5.74, duke treguar një diferencë mjaft të ngushtë në raport me vlerësimin maksimal. Ndryshoret më të lidhura për kënaqësinë e personelit janë

**“mjaftueshmëria e rrogës”, “numër i përshtatshëm studentësh”, “klasat” dhe “numri i stafit akademik për departament”,** parametra që përbëjnë edhe pjesën më të rëndësishme të aspekteve cilësore dhe sasiore të vlerësimit të punës dhe organizimit dhe që flasin për përmbushje të standardeve në këtë fushë.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat lidhur me sistemin e sigurimit të cilësisë, që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe që trajtojnë: funksionimin e strukturës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, numrin e anketimeve, numrin e pjesmarrjes së studentëve në anketime dhe mënyrën e funksionimit dhe raportimit të NJSBC në APB, janë korrekte dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e programeve mësimore dhe funksionimin e shërbimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në APB.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të</p>	<p>IAL “Akademia Profesionale e Biznesit”, nëpërmjet një strukture permanente – “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)”, realizon vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit nëpërmjet instrumentave matës dhe vlerësues.</p> <p>Institucioni e përfshin informacionin që rezulton nga vlerësimet e NJSBC në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Institucioni mbledh, përpunon dhe depoziton rezultatet e vlerësimit , por dhe i publikon ato.</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p>Sondazhe të studentëve që kanë përfunduar programin e studimit. Nga këto kontakte NJSBC ka arritur në përfundime se:</p> <p>a. Studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor pranë APB në përgjithësi janë të sistemuar me punë dhe kryesisht sipas profilit të tyre të studimit.</p> <p>b. Pjesa më e madhe e studentëve që kanë</p>

<p>mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>përfunduar studimet Bachelor kanë qendruar pranë APB për të vazhduar më tej studimet në nivelin Master Profesional dhe Shkencor.</p> <p>c. Pjesa më e madhe e studentëve që kanë përfunduar dhe/ose vazhdojnë studimet master profesional dhe shkencor janë në marrëdhënie të qëndrueshme pune, duke qenë të mbështetur nga njohuritë e marra në APB.</p> <p>d. Pjesa më e madhe e studentëve të APB në të dy nivelet Bachelor dhe Master kanë qendruar pranë APB edhe në rastin e ndjekjes së kurseve të kualifikimit dhe trainimit që organizohen nga ana e APB dhe që lidhen ngushtë me profesionet e tyre.</p> <p>Pyetësorë për pedagogët për kushtet e punës dhe për studentët. Këta pyetësorë përmbajnë pyetje lidhur me kushtet e punës në auditore dhe mundësitë që ofron Akademia Profesionale e Biznesit, si dhe pyetje për studentët, lidhur kryesisht me mundësitë dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive që studentët të aftësohen sa më shumë gjatë qëndrimit dhe kohës së studimit në Akademinë Profesionale të Biznesit. Ky pyetësor zhvillohet në mënyrë të fshehtë një herë në vit, në periudhën midis përfundimit të semestrit të parë dhe në fillim të semestrit të dytë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programet e ofruara nga IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" janë në përputhje me tregun e punës. Rreth 90% e të diplomuarve punësohen në profilin e tyre që në vitin e parë pas diplomimit.</li> <li>- Programet e ofruara nga IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" mundësojnë vazhdimin e studimeve në cikle të tjera studimi brënda dhe jashtë vëndit</li> <li>- Programi ka përgatitur studentë të aftë për t'u kualifikuar në studimet pasuniversitare në fushën e financës dhe kontabilitetit per kualifikime të mëtejshme akademike dhe profesionale jashtë shtetit.</li> </ul> <p>Teste të standartizuara kombëtare për profesionet e rregulluara, ekspert kontabel dhe kontabilist i miratuar. Pjesa më e madhe e studentëve të diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" që i janë nënshtruar provimit për marrjen e licencës Ekspert Kontabël dhe Kontabilist i Miratuar e kanë kaluar këtë</p>
--	--

	<p>provim dhe janë të licencuar “Ekspert Kontabël” dhe “Kontabilist i Miratuar”.</p> <p>Pjesëmarrje në konkurse të rangut kombëtar në nivel universitar në Republikën e Shqipërisë. Në konkursin e zhvilluar në muajin Prill 2015 nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, në rang kombëtar, ku morën pjesë universitete publike dhe private të RSh, studentët e IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” fituan vëndin e dytë.</p> <p>IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë në dokumentin e performancës së institucionit dhe raportin vjetor akademik.</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni, nisur nga fakti se ka një historik të shkurtër, ende nuk ka arritur që të botojë dhe publikojë broshura lidhur me vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Aktualisht është në proces të vlerësimit të veprimtarisë së strukturës së NjSBC duke synuar vendosjen në nivelin shkencor të punës së kësaj strukture në përgjigje të kërkesave të kohës.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Funksion i NJSBC-së është dhe përgatitja e Raportit Vjetor të vlerësimit të ecurisë së të gjitha programeve të studimit të ofruara në IALP APB.</p> <p>NjSBC- ja ka në funksion të saj rritjen e ndërgjegjësimit të brendshëm mbi çështjet e cilësisë së programeve të studimit të ofruara nga IALP APB, e cila nënkupton përcaktimin e metodave për përgatitjen e programeve mbi zhvillimin e cilësisë, për të arritur synimet dhe qëllimet e vendosura nga institucioni.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" është akredituar për herë të parë në nivel institucional në vitin 2012, sipas Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.557, datë 16.11.2012 "Për akreditimin institucional të Akademisë Profesionale të Biznesit".</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ndjek praktikën më të mirë dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	<p>NjSBC mbikëqyr dhe synon arritjen e standardeve në bashkëpunim me të gjithë aktorët përgjegjës të institucionit, duke vënë në fokus interesat e studentit. NjSBC garanton që sigurimi i cilësisë të harmonizohet me vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", përdor mekanizma zyrtarë, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, të cilat miratohen në Senatën Akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", punon për ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" diskuton në nivel departamenti të gjitha problematikat që lidhen me programin e studimit, zhvillimin e kurrikulës dhe të aspekteve të mësimdhënies, duke i transmetuar vendimet dhe diskutimet edhe në nivel Këshilli Fakulteti e më tej, për çështje të parashikuara në Statutin e Rregulloren e institucionit edhe në nivel Senatit, në mënyrë që praktikën më të mirë të uniformizohen si pjesë e politikave të përgjithshme të institucionit. Në kuadër të përmirësimit të kurrikulave mbi bazën e propozimeve të lektorëve të disiplinave përkatëse, bëhen ndryshimet e duhura, të cilat pasqyrohen në syllabuset e lëndëve.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> Nga shqyrtimi i detajuar i dosjes me syllabuset e Programit Master, RVB si dhe takimin me grupin e VB gjatë vizitës në IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", konkludojmë se në këtë institucion ekzistojnë dhe funksionojnë instrumentat për sigurimin e cilësisë së programeve në përputhje me standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Institucioni përdor</p>	



në mënyrë periodike instrumenta matës dhe vlerësues për ecurinë e programeve të studimeve, përfshirë: intervistat me studentët, orët e tutoriatit, anketimet/pyetësorët, etj,. Sigurimi i cilësisë garantohej nëpërmjet funksionimit permanent të një strukture autonome të specializuar - "Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC)", dhe është pjesë e dokumenteve strategjike të institucionit që, harton analiza dhe raporte periodike vjetore në të cilat jepen rekomandime për përmirësimin e procesit. Informacioni që buron nga procesi i vlerësimit të brendshëm është i aksesueshëm për të gjithë aktorët e interesuar.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkimore**

Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është hapur në vitin 2012, konform nr. 277, datë 02.07.2012 i Ministrit Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Menaxhim biznesi" dhe "Menaxhim Biznesi" pranë Akademisë Profesionale të Biznesit si pjesë e programeve të studimit që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky Program studimit është me kohë të plotë zgjat 2 vite akademike dhe ka numrin e krediteve 120 ECTS. Studentët pasë plotësimit të krediteve dhe pas provimit të Gjuhës së Huaj për marrjen e Certifikatës përkatëse, paisen me diplomën Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi".

**Objektivi kryesor** i programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi" është zgjerimi i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve, duke u ofruar studentëve të diplomuar "Bachelor në Ekonomi" apo edhe të fushave të tjera sipas kriterëve përkatëse, mundësinë e formimit si specialistë të lartë të menaxhimit të njësive ekonomike të sektorit publik e privat, si dhe t'u krijojë atyre, bazuar në legjislacionin e arsimit të lartë, rregulloret dhe kriteret e Institucionit si dhe në sistemin evropian të transferimit të krediteve (ECTS), mundësinë e vazhdimit të studimeve të mëtejshme në programe të tjera studimi të ciklit të tretë për fushat e ekonomisë, biznesit dhe menaxhimit.

Përfundimi i këtij Masteri krijon mundësi për thellimin e njohurive dhe vazhdimin e kualifikimit profesional dhe kërkimeve në sistemin e ciklit të tretë në fushat e mësipërme ose fusha të kombinuara që lidhen me Kontabilitetin e Financës dhe administrimin financiar të firmave e kompanive të ndryshme, OJF-ve, institucioneve të ndryshme, etj. Studentët që përfundojnë me sukses këtë program studimi mund të punësohen si: Ekspertë ose drejtues Kontabiliteti dhe finance në biznese të ndryshme, ekspertë ose drejtues të departamenteve të financës dhe kontabilitetit, zyra të shitjes dhe marketingut, zyra të analizave dhe kërkim-zhvillimit, ekspertë ose drejtues në zyrat apo departamentet e burimeve njerëzore, analistë tregjesh e çmimesh, analistë kredie dhe tregjesh financiare, menaxherë të përgjithshëm financiarë, etj.

#### **Tregues të matshëm:**

- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- Sasia e përgjithëshme e orëve mësimore për një vit akademik është 60 kredite x 25 orë mësimore /kredit = 1500 orë mësimore.
- 1 orë mësimore = 60'

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat lidhur me ndarjen e ECTS-ve sipas formave të mësimdhënies dhe përmirësimit e planeve mësimore, që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm janë të lidhura me sigurimin të cilësisë së këtij programi dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e programit mësimore.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- |                 |                       |                                   |
|-----------------|-----------------------|-----------------------------------|
| ▪ Për leksionet | 10 orë në auditor dhe | 15 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 7 orë në auditor dhe  | 18 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 25 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit  |

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Aneksi 7)

Gjatë verifikimit të të dhënave lidhur me planin mësimor sipas lëndve/moduleve, planin mësimor sipas veprimtarive dhe planin mësimor të lidhur me personelin, Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se të dhënat që janë të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm janë të sakta dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e këtij programi mësimore.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

Gjatë verifikimit të të dhënave lidhur me Vlerësimin e Syllabuseve dhe elementët e tyre, për çdo lëndë, konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë dhe departamentet e saj kanë bërë një punë të kënaqshme lidhur me hartimin, përditësimin dhe miratimin e syllabusit për çdo lëndë.

Nga verifikimi rezulton se çdo syllabus përmban: Emërtimin e lëndës/modulit, vitin/semestrin kur zhvillohet lënda, emrin e pedagogut, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës, njohurit dhe aftësitë që përfiton studenti, temat që trajtonë lënda, ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit, ECTS-t, format dhe metodat e mësimdhënies, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse.

Për sa sipër, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se të dhënat e syllabuseve përputhen me syllabuset që janë pjesë e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e këtij programi mësimore.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" është Akredituar me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr.557 datë 16.11.2012, "Për akreditimin institucional të Akademisë Profesionale të Biznesit" dhe programet që ajo zhvillon janë akredituar Me Urdhër nr.500 datë 18.10.2012 të Ministrit Arsimit dhe Shkencës "Për akreditimin e programeve të studimit Bachelor në "Drejtësi", Bachelor në "Ekonomi"; Master Profesional në "Menaxhim Biznesi" dhe "Menaxhim Biznesi".</p> <p>Struktura e vitit akademik garanton që studentit që ndjek një program studimi me kohë të plotë, në përfundim të vitit akademik realizon 60 kredite.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë, "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" ofron njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë të caktuar dhe specifike. Në këtë program studentit merr njohuri specifike të fushës së Kontabilitetit dhe Financës si dhe administrimit financiar me aftësi dhe kompetenca të nivelit të avancuar profesional e shkencor.</p> <p>Ky program është konceptuar të zhvillojë dhe thellojë më tej njohuritë e përfituara nga studentët në ciklin e parë të studimit Bachelor në Ekonomi në profilin "Administrim Biznesi".</p>

<p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" nëpërmjet një trajtimi të thelluar dhe bashkëkohor të njohurive në fushën e menaxhimit financiar dhe të Biznesit synon t'u japë specialistëve një sërë kompetencash profesionale dhe shkencore. Përvetësimi nga ana e studenteve e njohurive themelore të shkencave të drejtimit dhe administrimit të bizneseve në nivel lokal, kombëtar, rajonal, ndërkombëtar. Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve duke kombinuar njohuritë e sintetizuara të eksperiencës në këto fusha me njohuritë e reja dhe debatin bashkëkohor. Zhvillimi i aftësive kërkuese e hulumtuese të studentet.</p> <p>Studentët të cilët përfundojnë me sukses këtë program studimi mund të punësohen si: Ekspertë ose drejtues në biznese të ndryshme, ekspertë ose drejtues të departamenteve të financës dhe kontabilitetit, analistë kredie dhe tregjesh financiare, menaxherë të përgjithshëm, etj.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është konceptuar dhe implementuar me synimin për arritjen e objektivave të përcaktuar në momentin e licencimit të tij, si një program i ciklit të dytë, me të gjitha tiparet e një programi studimi shkencor.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve në këtë cikël studimi janë të larmishme dhe dinamike në varësi të specifikave të lëndës. Megjithatë këto metoda variojnë në:</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve, poshtë:</p>

	Vlerësim angazhimi në seminar (1deri 10 pikë), Detyrë kursi /Prezantime/Punë kërkimore shkencore (1deri 30 pikë) Provim me shkrim (1deri 60 pikë)
<b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" mbështetet në praktikat më të mira kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit përfaqëson vlerat e arsimit shqiptar. Ky program bazohet në traditën ligjore kombëtare dhe zakonet e mira të vëndit tonë. IALP APB ka dëshmuar ndër vite se programet që ofron përmbahen rigorozisht parimeve dhe standardeve ndërkombëtare, çka dëshmohet dhe në mobilitetin pa pengesa që kanë pasur studentët e diplomuar ndër vite.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje më të gjitha objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Ky program studimi ofron studime të thelluara teorike dhe praktike në fushën e Kontabilitetit, Financës dhe Administrimit financiar.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me profilin e Fakultetit të Ekonomisë duke vazhduar njohuritë e thelluara në ciklin e parë të programit Bachelor në Ekonomi në profilin "Financë Kontabilitet".</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë në IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka në strukturën e tij Qendrën e Kërkimit Shkencor si një departament të vecantë, i cili ka objektiv kryesor kërkimin shkencor në rang fakulteti. Pavarësisht qendrës kërkimore si departament i Fakultetit të Ekonomisë çdo pedagog i IAL "Akademia e Profesionale Biznesit" angazhohet në kërkim shkencor individual në fushën në të cilën ai lepton dhe motivohet të vazhdojë karrierën akademike në fitimin e gradave dhe titujve të mëtejshëm.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Administrim Biznes është hartuar duke pasur parasysh nevojat në perspektive të zhvillimit ekonomik të vendit dhe duke iu përshtatur kërkesave në ndryshim të tregut, si në institucionet e ndryshme publike, ashtu edhe në kompani private.</p> <p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në AB, është aktual dhe u përgjigjet nevojave të tregut kombëtar të punës.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" i ofruar nga IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" është në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë të njohura nga MAS dhe respekton traditën kombëtare.</p> <p>Programi i studimit bazohet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe vlerat kombëtare të fushës.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>APB ofron programe studimi të ciklit të dytë, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Studenti në një vit akademik duhet të grumbullojë 60 kredite. Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Administrim Biznes realizohet me 120 kredite europiane (ECTS) për 2 vite akademike.</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike</p>	<p>Të gjitha syllabuset e lëndëve të ofruara në këtë program studimi janë lehtësisht të aksesueshme. Studentët mund të paraqesin kërkesë në sekretarinë ose zyrën e kancelarit të institucionit për të marrë informacion mbi planin mësimor, stafin akademik dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>Informacionet lidhur me programet e studimit të ofruara në IAL APB, me historikun, statusin juridik si dhe ato të parashikuara me ligj janë të publikuar në faqen zyrtare eeb të APB. Informacion më i detajuar në lidhje me planin mësimor, stafin akademik dhe syllabuset e lëndëve mund të gjendet në format të shkruar dhe është i aksesueshëm me kërkesë të çdo studenti në sekretarinë përkatëse apo pranë zyrës së kancelarit të institucionit.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Akademia Profesionale e Biznesit i pajis studentët që kanë përfunduar një program studimi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Diplomat shoqërohen me suplementin e diplomës, përmbajtja dhe forma e të cilave miratohen nga Senati akademik i APB, në përputhje me udhëzimet e MAS-it. Diploma e lëshuar regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, i cili mbahet në MAS.</p> <p>Në përfundim të programit, përveç testimeve të njohurive në lëndët përkatëse studenti zhvillon dhe një punë kërkimore shkencore nën udhëheqjen e pedagogut përkatës (me grada dhe tituj në përputhje me Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar). Kërkimi shkencor sipas këtij programi studimi është vlerësuar me 30 kredite. Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Kontabilitet Financë i bashkëngjitet raportit.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Të gjitha programet e licencuara dhe të akredituara të ofruara nga institucioni janë në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij kryesor që është: diplomimi dhe kualifikimi i studentëve me dije shkencore dhe praktike në fushën e ekonomisë. IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e saj dhe i përmbahen parimeve dhe standardeve ndërkombëtare, çka dëshmohet në mobilitetin pa pengesa që kanë studentët e diplomuar nga ky institucion.</p> <p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është hartuar në përputhje me të gjitha objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Studentët mund të aksesojnë pa pengesa çdo informacion që lidhet me programin e studimit, strukturën kurrikulare.</p> <p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" realizohet me 120 kredite europiane (ECTS) për 2 vite akademike, dhe i ofron studentit studime të thelluara teorike dhe praktike në fushën përkatëse.</p> <p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" është aktual dhe u përgjigjet të gjitha nevojave të tregut. Ky program bazohet në legjislacionin aktual në fuqi dhe</p>	

trajton çështjet më të rëndësishme në këtë fushë.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

Sipas verifikimit të bërë nga grupi i vlerësimit të jashtëm rezulton se: Veprimtaria mësimore në këtë program realizohet në gjuhën shqipe nëpërmjet kombinimit efektiv të një larmie metodash si p.sh.: leksione, seminare, praktika, analiza e situatave të ndryshme studimore, prezantime, detyra kursi dhe projekte kërkimi. Raporti midis orëve praktike dhe atyre teorike është i balancuar.

Metodologjia e mësimdhënies përbën një pikë të fortë të programit të studimit. Programi nxit e stimulon mendimin kritik, lidhur me problemet që has financieri dhe kontabilisti në ditët e sotme, duke vënë theksin te përfundimi i një financieri dhe kontabilisti që ofron efektivitet dhe efikasitet në punën e tij në grup, duke synuar në perspektivën e afërt, edhe grupe shumëkulturale, një aftësi kjo e paçmueshme për një menaxher modern, të ditëve të sotme.

Fakulteti i Ekonomisë nëpërmjet këtij programi u ofron studentëve mundësinë për të mësuar jo vetëm koncepte, por edhe teori të kontabilitetit dhe financës apo të menaxhimit dhe raportimit financiar, si edhe u kërkon atyre punë të pavarur e aktivitet praktik, në shërbim të formimit sa më të mirë profesional, duke ofruar një program gjithëpërfshirës bashkëkohor që krijon hapësirë për personalizim, profesionalizëm, fleksibilitet dhe njohje të standardeve kombëtare e ndërkombëtare të kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit.

Mësimdhënia është e organizuar me formën standarde dy semestre për vit shkollor, me lëndë me kohëzgjatje semestrale, me formën leksion/seminar. Shtrirja faktike është 15 javë në një semestër, 60 minuta/orë mësimi. Në përgjithësi, për të gjitha lëndët që zhvillohen në programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Biznesi" orët e mësimimit janë shpërndarë në mënyrë të barabartë. Ky program ka gjithsej 3000 orë mësimore, përfshirë edhe orët e studimit individual.

Në rregulloren e programit të studimit, një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve. Forma e vlerësimit të dijeve të studentëve për çdo lëndë është e përcaktuar në syllabuset e programit të studimit, ku studenti i nënshtrohet një vlerësimi të vazhdueshëm duke konsideruar vlerësimet e marra në kontrollet e ndërmjetme dhe vlerësimin nëpërmjet provimit përfundimtar, i cili zë një masë të konsiderueshme të vlerësimit të studentit (rreth 60% të notës totale) për lëndët përkatëse. Kontrolli i dijeve për modulin përkatës realizohet në dy faza:

- Kontrolli i fazës së parë përfshin kontrollin gjatë procesit mësimor, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, punët laboratorike, provime ndërmjetëse, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikën mësimore etj. Vlerësimi i kësaj faze përfshin 40% të vlerësimit total të modulit.



- Kontrolli i fazës së dytë përfshin kontrollin nëpërmjet provimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar përfshin 60% të totalit që së bashku me rezultatin e arritur nga studenti gjatë vitit (40%) përbën 100% të vlerësimit përfundimtar.

Për sa sipër, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se të dhënat lidhur me organizimin dhe format e mësimdhënies, ngarkesën mësimore, metodat dhe teknologjinë e mësimdhënies, cilësinë zhvillimit të mësimi, kontrollin e njohurive të studentëve dhe vlerësimin e brendshëm përputhen me të dhënat që janë pjesë e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e këtij programi mësimore.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

Gjetë verifikimit rezulton se pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi", pranë IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", realizohet në përputhje me Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimet normative të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Statutin dhe Rregulloren e IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", si edhe Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi". Kjo dëshkohet edhe nga fakti se të gjithë studentët e regjistruar janë paisur me numër matrikulli "NIM" nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Nga verifikimi rezulton se për studentët që nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Rektoratit janë nxierr urdhërat e ç'rregjistrimit, të cilët janë shënuar në regjistrin themeltar.

Nga verifikimi rezulton se nota mesatare e studentëve në hyrje ishte nga 6.5 deri 7.5 dhe në përfundim të një viti tentohet të ruhet kjo mesatare, ndërkohë që nga viti në vit mesatarja në dalje ka tendenca në rritje. Numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite ruhet në nivelet 83.3% -95% sipas kalueshmërisë nga viti i parë në vitin e dytë dhe 100% sipas kalueshmërisë nga viti i dytë deri në diplomim të këtij programi studimi. Mbi 95% e studentëve kanë tendencën të mbarojnë studimet e ciklit të dytë brenda afateve normale të përcaktuara për këtë cikël studimesh (2 vjet) dhe vetëm një pjesë e vogël ka tendencën të mbarojë me vonesë këto studime. Kalueshmëria e studentëve për çdo vit varion përafërsisht nga 83.3% - 90% për vitin e parë dhe 100% për vitin e dytë, ku problematika kryesore lidhur me këtë përqindje të pakalueshmërisë është mosfrekuentimi dhe mosparaqitja e tyre në provime. Rreth 80% e studentëve janë diplomuar pa vite përsëritëse në këtë program studimi.

IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" gjeneron statistika për studentët duke respektuar kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **Raportet me studentët dhe të diplomuarit**

IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ndërton marrëdhënie shumë të mira komunikimi me studentët, si gjatë procesit mësimor ashtu dhe pas diplomimit. Studentët kontaktojnë shpesh pedagogët dhe diskutojnë mbi problematikat e hasura në praktikë. IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka ngritur një strukturë të veçantë - Zyrën e Tutoriatit dhe Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të studentëve, u mundëson atyre leksione të hapura me të ftuar akademikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, trajnime profesionale në fushën ekonomike, internshipe si edhe praktika të ndryshme profesionale në institucionet publike dhe private me të cilat kjo zyrë ka komunikime të vazhdueshme.

Pranë IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" funksionon edhe rrjeti i studentëve ALUMNI, i cili bashkon të diplomuarit ndër vite. Roli i Rrjetit të Studentëve ALUMNI është të ruajë një marrëdhënie të vazhdueshme mes studentëve aktualë, stafit akademik dhe të gjithë të diplomuarve. Rreth 80 % e studentëve që kanë përfunduar studimet në APB, janë të punësuar

Për sa sipër, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se të dhënat lidhur me procedurat e pranimit dhe informimin e studentëve, cilësinë në hyrje, numrin studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, kohën mesatare të zgjatjes së studimeve, kalueshmërinë, statistikën, punësimin dhe komunikimin me studentët e diplomuar, përputhen me të dhënat që janë pjesë e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me zhvillimin e këtij programi mësimor.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënljore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në</p>	<p>Për t'u pranuar në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Menaxhim Biznesi" dhe "Financë-Kontabilitet" studentët duhet të zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" "Menaxhim Biznesi" realizohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënljore si dhe me aktet dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni.</p> <p>Në përfundim të studimeve të këtij cikli, studentët nuk diplomohen nëse nuk kanë paraqitur dokumentin e mbrojtjes së gjuhës angleze sipas kriterit ligjor, që i përgjigjet Nivelit B2. Nga ajo që</p>

<p>diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>u konstatua në terren Institucioni bën vlerësime të herë pas hershme sa i përket politikave dhe kriterëve të pranimit dhe ndikimit të tre në ecurinë dhe avancimin e mëtejshëm të studentëve.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin ndjek në vazhdimësi ecurinë e programit dhe bën sugjerimet përkatëse për ndryshime, përfshi edhe kriteret e pranimit, në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p>
<p><b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në procesin e regjistrimit dhe përgjatë zhvillimit të programit studentëve u jepet informacion i hollësishëm lidhur me mundësitë për punësim që programi ofron, si dhe të dhëna të plota lidhur me performancën e institucionit.</p> <p>Studentëve u jepet informacion i detajuar mbi akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, vlefshmërisë së diplomës, etj., nëpërmjet platformës elektronike, broshurave informuese, por edhe dokumentit mbi performancën e institucionit si pjesë e kontratës së regjistrimit të studentit.</p> <p>Në IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” funksionon Zyra e Tutoriatit dhe Karrierës, e cila ofron në vazhdimësi, gjatë të gjithë procesit të realizimit të programeve të studimit, në të gjitha nivelet, këshillimin periodik të studentëve. IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” ka krijuar databazën e studentëve që diplomohen me të dhënat e tyre bazë të komunikimit (numër telefoni dhe e-mail), si dhe në vijimësi edhe të të dhënave të tyre lidhur me punësimin dhe karrierën.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>IAL “Akademia Profesionale e Biznesit” gjeneron statistika periodike për numrin e të regjistruarve dhe të të diplomuarve, bazuar në Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e MAS,</p>

	Nr.9, datë 25.02.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore" për sistemin universitar,
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Në Udhëzimin e MAS, Nr.31, datë 16.09.2014 "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat me regjistrat bazë të studentëve", si dhe udhëzime të tjera të MAS që dalin për çdo vit akademik.IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar , tërheqjet nga programi, largimet parapërfundimit si dhe/apo mospërfundimin e studimeve dhe i raporton ato rregullisht në MAS sipas udhëzimeve të vazhdueshme dhe afateve të përcaktuara nga kjo Ministri.</p> <p>Gjithashtu, IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" disponon të dhëna për ecurinë e formimit të tyre profesional nga pranimi deri në diplomim të cilat i raporton periodikisht në MAS.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" nëpërmjet sekretarisë mësimore, mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të këtij programi të studimit, si dhe për vendet e punësimit të tyre.</p> <p>Aktualisht, IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" nuk disponon një bazë të dhënash për studentët që përfundojnë këtë program studimi dhe që vazhdojnë studimet e mëtejshme, por në të ardhmen e afërt mendohet që të krijohet edhe një bazë e tillë duke filluar nga brezi i vitit aktual të diplomimit.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Tutoriatit dhe Karrierës, por edhe nga stafi akademik, mbi programin e studimit, statusin e tij - i akredituar ose jo, organizimin e studimeve dhe kohëzgjatjen e këtij programi.</p> <p>Gjithashtu, Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.</p> <p>Në secilin prej moduleve, studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate.</p>

<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ofron shërbimin e këshillimit studentëve, u mundëson atyre leksione të hapura me të ftuar akademikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, trajnime ekstrakurrikulare, internship-e dhe praktika të ndryshme profesionale në institucionet publike dhe private.</p> <p>Subjektet në të cilat studentët kryejnë praktikat profesionale apo intershipe, përveç institucioneve të shumta me të cilat APB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, janë edhe institucione të njohura shtetërore me orientim ekonomik në veprimtarinë e tyre, të tilla si: Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Departamentet dhe Drejtoritë Ekonomike dhe të Financës në disa institucione shtetërore, DAP, AKP, banka dhe biznese private me reputacion si SICRED sh.a, etj.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Pranimet në Fakultetin e Ekonomisë në IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" realizohen konform të gjitha rregullave dhe procedurave të legjislacionit në fuqi, specifikuar në Statutin dhe në rregulloren e programit të studimit. Studentëve u jepet informacion i detajuar mbi akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, vlefshmërisë së diplomës, etj. Studentëve u jepet informacion i hollësishëm lidhur me mundësitë për punësim që programi ofron, sikundër të dhëna të plota lidhur me performancën e institucionit dhe studentëve ALUMNI</p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" mban statistika vjetore të rregullta për numrin e studentëve të regjistruar dhe bazën e të dhënave mbi punësimin e të diplomuarve dhe respekton të drejtat e privatësisë së studentit dhe respekton ligjin për të dhënat personale. IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ofron akses të plotë të studentëve për materialet didaktike, bazën laboratorike, mjediset çlodhëse si edhe garanton marrdhënie konstante të tyre me stafin akademik i cili ofron shërbime këshillimore në dobi të studentëve.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së Tutoriatit dhe Karrierës sigurohet ndjekja e vazhdueshme e studentëve edhe pas përfundimit të studimeve, duke siguruar kështu informacion të vazhdueshëm lidhur me karrierën e studentëve që përfundojnë studimet në Akademinë Profesionale të Biznesit.</p> <p>Nga bisedat me stafin dhe takimi me studentët rezultoi se ky Institucion ka në kujdes studentët e programi studimesh.</p>	

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

#### **10. Kërkimi shkencor**

##### **Pjesa përshkrimore**

Nga verifikime rezultoi se IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" në fushën e kërkimit shkencor ka synuar të arrijnë këta objektiva:

- ✓ Rritjen e performancës së stafit akademik;
- ✓ Reflektimin e kërkimit dhe performancës shkencore në auditor me studentët;
- ✓ Krijimin e marrëdhënie të bashkëpunimi me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare për hulumtime shkencore të përbashkëta;
- ✓ Organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në botime.

Për të aritur këto synime IAL "Akademia Profesionale e Biznesit", nëpërmjet njësive të kërkimit shkencor në përbërje të saj:

- ✓ Ka nxitur, mbështetur dhe realizuar botimin e periodikut të saj shkencore nga ku rezulton se IAL "APB" publikon revistën periodike "Scientific Journal of Professional Studies" me ISSN 2412-5865, e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë tij.
- ✓ APB ka marrë pjesë si partnere në një **projekt kombëtar** në kuadrin e "**Rritjes së pjesëmarrjes së femrave në biznes**", e mbështetur nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale si dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Ka organizuar 4 Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare si më poshtë:

- ✓ **Konferenca I Ndërkombëtare Shkencore**, me temë "**Zhvillimet bashkëkohore, sfidat dhe perspektivat**" më 14 qershor 2013, ku të gjitha punimet shkencore të konferencës janë botuar në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN 978-9928-123-59-6.
- ✓ **Konferenca II Ndërkombëtare Shkencore**, me temë "**Ndryshimi global - impakti ekonomik dhe ligjor**" më 29 prill 2014, ku të gjitha punimet shkencore të konferencës janë botuar në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-123-80-0.
- ✓ **Konferenca III Ndërkombëtare Shkencore** me temë "**Sustainable Development and Life Quality Improvement in Albania toward EU Integration process**", ku të gjitha punimet shkencore të konferencës janë botuar në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-187-25-3.
- ✓ **Konferenca IV Kombëtare Shkencore** me temë "**Pushteti Gjyqësor dhe Integrimi European i Shqipërisë**" më datë 04.06.2015 ku të gjitha punimet shkencore të konferencës janë në process botimi.

Nga verifikimi rezulton se aktiviteti shkencor individual i stafit akademik të IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" evidentohet çdo vit akademik nëpërmjet plotësimit të formularit të standardizuar për këtë aktivitet. Sipas verifikimit numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL është 71, numri i projekteve kërkimore të fituara dhe të zbatuara është 1, numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL është 5, numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL është 120, numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor është 63 dhe numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 20

Për sa sipër, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se megjithëse Akademia Profesionale e Biznesit është një IAL, relativisht e re, ka bërë hapa lidhur me kërkimin shkencorë, por të dhënat lidhur me politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi nuk janë specifikuar nga të dhënat e përgjithshme. Gjithësesi, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se të dhënat e raportuara, përputhen me të dhënat që janë pjesë e raportit të vlerësimit të brendshëm të dërguar në APAAL dhe përgjithësisht sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me kërkimin shkencor në shkallë institucioni.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik është i angazhuar në publikimet periodike në organin e saj shkencor, por edhe në publikimet në revista ndërkombëtare me faktorë impakti. Një pjesë e mirë e personelit akademik të IAL APB janë autorë tekstesh mësimore, monografive shkencore dhe cikleve të leksionit në funksion të programeve të studimit të ofruara nga IAL APB.</p> <p>APB ka publikuar numrin 1 të revistës dhe është në fazën e procedimit për numrin 2. Angazhimi në kërkim shkencor ka rritur cilësinë e mësimdhënies dhe pedagogët kanë qenë burim i ideve në funksion të zgjidhjes së problemeve në kuadër të reformimeve ekonomike dhe forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p> <p>Akademia Profesionale e Biznesit ka në kurrikulën e saj në Ciklin e parë Bachelor për të dy fakultetet lëndët e formimit gjuhësor: Gjuhë e Huaj (Anglisht I) dhe Anglisht Biznesi. Titullari i lëndës Anglisht I, është personel akademik efektiv në APB. Ndërsa lënda Anglisht Biznesi ka si titullar një pedagog anglez (personel akademik me kontratë) Mr. Andy Zdan-MICHAJLOWICZ.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtijshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Në IAL "APB" forma më e preferuar ka qenë ajo e debatit akademik nëpërmjet një programi që funksionon rregullisht në formën e leksioneve të hapura për avancimin e metodave të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në këto leksione janë ftuar lektorë dhe ekspertë vendas e të huaj me përvojë të pasur mësimore.</p> <p>Personeli akademik i IAL APB është mbështetur për kualifikime të mëtijshme, brenda ose jashtë vendit, si dhe për ndjekjen e procedurave në përfitimin e titujve dhe gradave shkencore. Aktualisht, 4 pedagog Efektiv në procesin e kualifikimit në kërkim të gradës shkencore "doktor", 1 prej të cilëve në Itali.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë</b>	





<b>kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>IAL "APB" disponon të dhëna për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë personeli akademik.</p> <p>Institucioni ka bazën e plotë të të dhënave të personelit me kualifikimet përkatëse shkencore. Aktiviteti shkencor individual i stafit akademik të IAL APB evidentohet dhe inkuadrohet në raportin vjetor të veprimtarisë akademike.</p> <p>Institucioni, po bënë përpjekje për të krijuar një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" krijon kushte për zhvillimin e aktivitetit kërkimor shkencor në nivel institucional dhe mbështet veprimtarinë kërkimore shkencore individuale të personelit akademik. Ajo planifikon një veprimtari intensive në drejtim të kërkimit duke angazhuar të gjitha kapacitetet e saj humane.</p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" publikon revistën periodike "Scientific Journal of Professional Studies" me ISSN 2412-5865, e cila është një tribunë e mendimit shkencor.</p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" tërheq pranë auditorëve të saj herë pas here personalitete të fushave të caktuara që lidhen me programet e saj të studimit, duke transferuar tek auditorët e saj përvojën më të mirë në këtë drejtim.</p> <p>IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" ka të dhëna për të gjitha punimet dhe studimet shkencore, kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit të ofruara nga IAL "Akademia Profesionale e Biznesit".</p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

Akademia Profesionale e Biznesit realizon një bashkëpunim të admirueshëm me institucione të standardeve më të larta, qofshin këto brenda saj apo jashtë vendit, me qëllim rritjen e cilësisë së ofertës akademike si dhe ndërkombëtarizimin e diplomave. APB ka nënshkruar, dhe është në proces nënshkrimi, të marrëveshjeve të ndryshme me insitucione qeveritare dhe universitetet shqiptare publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit. Në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, për arritjen e objektivave në ofrimin e edukimit sa më cilësor dhe ndërkombëtarizimin e procesit të edukimit, është e angazhuar, në mënyrë sistematike, për zgjerimin e bashkëpunimit në planin kombëtar

dhe atë ndërkombëtar. Institucioni ka realizuar bashkëpunime të frytshme me institucione të tjera homologe, të cilat janë materializuar në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si trajnime për studentët dhe personelin akademik, leksione të hapura, seminare, etj.

Në këtë kontekst vlen për t'u theksuar disa Marrëveshje Mirëkuptimi midis IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" dhe disa institucioneve arsimore prestigjioze, të tilla si: Accademia Internazionale Costantiniana Delle Scienze Mediche, Giuridiche e Sociali, Romë - Itali; Universitetit të Boras në Suedi; Universitetit të Krajovës në Rumani; "Dimitrie Cantemir" University in Targu Mures - Rumani; University of National and World Economy Sofie - Bullgari, ku ndër të tjera është shprehur interesi i të dy palëve për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta programore për shkëmbimin e studentëve në kuadër të programit ERASMUS+ si dhe shkëmbimin e stafeve akademike në funksion të mobilitetit të stafeve apo studentëve, duke e bërë më të prekshëm realitetin ndërkombëtar akademik.

Sipas verifikimit rezulton se ekzistojnë 12 marrëveshjeve të nënshkruara për bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë dhe 31 marrëveshje me institucionet e biznesit, të cilat inkurajonë dhe nxisin krijimin e aleancave të suksesshme me aktorë të rëndësishëm të biznesit në vend, si dhe sigurojnë bashkëpunim të ngushtë për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale për studentët e APB.

Përveç marrëveshjeve të konkluduara, IAL "Akademia Profesionale e Biznesit" punon në mënyrë të vazhdueshme për të bashkëpunuar dhe konkluduar marrëveshje, me aktorë në fusha të ndryshme të ekonomisë si dhe realizuar rreth 13 veprimtari me lektorë të huaj dhe 18 veprimtari me personalitete të jetës politike, shkencore dhe akademike, si dhe me lektorë dhe ekspertët vendas.

Për sa sipër, Grupi i vlerësimit të jashtëm, konstaton se bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës, përputhen me të dhënat që janë pjesë e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe sigurojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë nga vizita në institucion

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike e private, në Shqipëri dhe siguron kushte të plota për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional" dhe "Bachelor", për të dy njësit kryesore të saj.</p>
<p><b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>IAL "APB" krijon ambientin e nevojshëm profesional dhe stimulon bashkëpunimin e personelit. Kjo qasje reflektohet në një ndarje të qartë të përgjegjësive dhe detyrave dhe frymën e grupit në përballimin e sfidave.</p> <p>Njësitë kryesore dhe bazë organizojnë takime e analiza periodike për aspekte të ndryshme të punës në institucion dhe sigurojnë kolegjalitetin e nevojshëm në vendimmarrjet më të rëndësishme.</p>
<p><b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>IAL APB për realizimin e objektivave të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorë biznesi.</p> <p>IAL APB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për të mundësuar kryerjen e praktikave profesionale nga studentët. Në varësi të programit të studimit këto praktika janë realizuar pranë bizneseve, studiove profesionale, gjykatave të ndryshme etj.</p> <p>IAL APB nëpërmjet marrëdhënieve që ka vendosur me organizata ka realizuar në vazhdimësi trajnime, ëorkshop-e etj., që u krijojnë mundësi studentëve të marrin njohuri praktike dhe thellojnë dijet.</p> <p>Institucioni analizon në vazhdimësi ecurinë</p>

	e marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programeve të studimit. Përfitime financiare nga marrëveshjet nuk ka pasur.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> IAL APB ka realizuar bashkëpunime të frytshme me institucione të tjera homologe dhe aktorë të biznesit, brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë materializuar në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, ka siguruar organizimin e praktikave mësimore të studentëve dhe internship-e në institucione të ndryshme apo biznese vëndase, duke krijuar në këtë mënyrë lidhjen student – tregu i punës. IAL APB funksionon si një qendër e rëndësishme e gjenerimit të ideve, dialogut me aktorë të rëndësishëm vendas apo të huaj, nëpërmjet aktiviteteve të larmishme që përfshijnë: organizimin e leksioneve të hapura, debatet për çështje me rëndësi kombëtare, etj.	

### ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës **SËOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

#### a) Pika të forta:

1. Profil institucional i orientuar drejt profesionalizmit, dijes dhe vlerave.
2. Strukturë organizative e përshtatshme
3. Lidhje me botën e biznesit dhe “netëork” funksional me organizatat profesionale.
4. Koherencë e plotë midis programeve të studimit, vizionit, misionit dhe planit strategjik të zhvillimit.
5. Marëdhënie institucionale me sektorin privat dhe “internship” pranë biznesit.
6. Partneritet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.
7. Struktura kurrikulare mbështetet plotësisht në kërkesat e tregut dhe modelet më të mira perëndimore.
8. Laboratorë modernë (informatika).
9. Specializim i ngushtë në vetëm dy fusha studimi ekonomi dhe jurisprudencë.
10. Vlerësimi konstant i performancës së stafit akademik nga studentët.
11. Vlerësimi i saktë dhe objektiv i performancës së studentëve.
12. Ofrimi i bursave të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentët e ekselencës.
13. Akses i lehtë i kampusit në raport me infrastrukturën kryesore të qytetit.
14. Raporte shumë të mira drejtues-pedagog dhe pedagog-student
15. Trajnime, transferim të njohurive dhe përditësim të vazhdueshëm të dijeve dhe standardeve në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar.
16. Integrimi i qendrave trajnuese brenda strukturës së APB.

17. Fasilitete dhe logjistikë adekuate për stafin dhe studentët.
18. Prirje të forta të strukturave drejtuese për aplikim të praktikave innovative.
19. Fluiditet dhe intensitet i komunikimit në drejtim vertikal dhe horizontal.
20. Rritja graduale e numrit të programeve të ofruara nga institucioni.

**b) Pika të dobëta:**

1. Moshë e re e institucionit.
2. Numri i titujve dhe njësive në bibliotekë është i relativisht i kufizuar, pavarësisht masave që po merr APB për pasurimin e saj.
3. Pamjaftueshmëri e barasvlerësimit të njohurive menaxheriale bazike të të gjithë studentëve që në hyrje në këtë program studimi.
4. Mungesë e një hapsire të mjaftueshme parkimi apo e një tereni sportiv.
5. Informacion i kufizuar për mundësitë e financimit të jashtëm. Në këtë kuadër na u tha se APB po punon për të konsoliduar marrdhëniet që mbështesin financimin e jashtëm i cili pa dyshim do të përmirësoj edhe cilësinë e mësimdhënies në të ardhmen.
6. Bashkëpunime në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

**c) Mundësitë:**

1. Rritje konstante e kërkesës së brendshme për studime në nivele më të larta [ bachelor te vetë APB].
2. Trendi i dukshëm "long life learning" me rezultat: rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm.
3. Rritja e preferencës së studentëve për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve në profilet ekonomike.
4. Numri në rritje i kontingjentit që përfundojnë ciklin e studimeve në programin Administrim Biznesi.
5. Zgjerimi këmbimeve studentore dhe akademike përmes "Horizon 2020" dhe implementimi i standardeve të Bolonjës për mobilitetin e studentëve apo mundësive të tjera nëpërmjet financimeve nga BE [ Tempus, Erasmus, etj.].
6. Rritja e preferencës së studentëve për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve në profilet ekonomike
7. Rritja e numrit të maturantëve.

**d) Pengesat:**

1. Probleme strukturale me tregun e punës në lidhje me profilin dhe specialitetin e të diplomuarëve.

2. Ndikimi i krizës financiare globale në burimet financiare të publikut të gjerë dhe të institucionit.
3. Fenomeni "Brain-Drain", përfshi këtu, pedagogët e rinj dhe studentët që synojnë institucione të huaja arsimore.
4. Konkurrencë ndonjëherë e deformuar në tregun e IAL-ve si dhe numri i madh i institucioneve të arsimit të lartë jopublik në Shqipëri.
5. Sinkronizim joadekuat i specialistëve të sapodiplomuar me tregun e punës

### **Rekomandime**

1. Të kryhen studime më të detajuara për kërkesat e tregut të punës në Shqipëri për periudha aftashkurtra.
2. Të shikohet mundësia e freskimit të ekipit mësimdhënës me specialistë me tituj dhe grada shkencore më të avancuara.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

**Përbërja e GVJ:**

**Prof.Dr. Mimoza Manxhari**



## ANEKSI 1

**Tabela 1:** Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti Ekonomik	Departamenti i Menaxhimit					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	<b>7</b>	3 Dr. 2 Dr.proces 2 Msc	<b>8</b>	1 Prof.Dr 4 Prof.as. 1 Dr 1 Dr. proces 1 MSc	<b>15</b>	1 Prof.Dr 4 Prof.as. 4 Dr 3 Dr. proces 3 MSc

## ANEKSI 2

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti Ekonomisë - Departamenti i Menaxhimit							
Personeli Akademik Efektiv Emër Mbiemër	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë Emër Mbiemër	Titulli /Grada	Institucio ni ku punon “full time”		
1. Enriko CEKO	Përgjegjës	Dr.	1. Vjollca BAKIU	Prof.Dr	FE, UT		
2. Pjeter NDRECA	Anëtar	Dr.	2. Remzi KECO	Prof.as.Dr	FEA, UBT		
3. Rezart DIBRA	Anëtar	Dr.	3. Kujtim DULE	Prof.as.Dr	FEA, UBT		
4. Enis FITA	Anëtar	Dr.Proces	4. Majlinda BELEGU	Prof.as.Dr	FEA, UBT		
5. Nevila XOXA	Anëtar	Dr.Proces	5. Ilir KAPAJ	Prof.as.Dr	FEA, UBT		
6. Indrit AGO	Anëtar	Msc.	6. Ervin HOXHAI	Dr.	FE, UT		
7. Ana MUKA	Anëtar	Msc.	7. Aurela BRAHOLLI	Dr.proc.	FE, UT		
			Andy Zdan-Michajloëicz	MA (Hon)			

## ANEKSI 3

Tabela 3: Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Nr.	Emër Mbiemër	Titulli/Grada	Pozicioni në Këshillin Shkencor
1.	Enriko CEKO	Dr.	Përgjegjës i programit të studimit
2.	Enis FITA	Dr.Kand.	Koordinator i programit të studimit
3.	Rezart DIBRA	Dr.	Anëtar

**ANEKSI 4**

Tabela 4: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Titulli	Departamenti i Financë Kontabilitetit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	1	0/1
Profesorë të As.	0	4	0/4
Doktorë	3	1	3/1
Lektor Doktorant	2	1	2/1
Lektor me MSC	2	1	2/1
Personeli Administrativ	8*		

**ANEKSI 5**

Tabela 5: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Nr.	Anëtarët e NJSBC	Detyra në NJSBC
1	Enriko Ceko	Kryetar
2	Ina Gjoni	Anëtar
3	Florian Peçuni	Anëtar
4	Adela Çulani	Anëtar
5	Ledio Shyti	Anëtar/ student

**ANEKSI 6**

Tabela 6: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore														Gjithsej	Provime					
			Leksione			Seminare			Laborat or			Praktik e			Orë në auditor	Punë e Pavarur							
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur									
1	Lënda 1-Ishte: Menaxhimi i projekteve	I	6	3	3	4	5	3	3	0	45	-	-	--	-	-	--	60	9	0	15	0	1
	Lënda 1:u ndryshua Qeverisja Korporative	I	6	6	3	4	5	3	3	0	45	-	-	--	-	-	--	60	9	0	15	0	1
2	Lënda 1-Ishte: Menaxhimi operacional	I	6	3	3	4	5	3	3	0	45	-	-	--	-	-	--	60	9	0	15	0	1
	Vlerësimi i ndërmarrjeve	I	6	6	3	4	5	3	3	0	45	-	-	--	-	-	--	60	9	0	15	0	1
Ndryshime në Total		-	--	-	--	--	--	--	--	--	--	-	-	--	-	-	--	--	--	--	--	--	-



## ANEKSI 7

Tabela 7: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda /Moduli	Pedagogët përgjegjës	Titulli/gra da kualifikimi	Departamenti	Ngarke sa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1. Metodat e kërkimit shkencor	Simon GEGA	Prof.As.Dr.	Qendra Kërkimore e FD	60	PAE
2.1 Etika avancuar	Ariet MALAJ	Dr.	Dep. Financës	30	PAE
2.2 Taksim i Avancuar	Rezart DIBRA	Dr.	Dep. Menaxhimit	60	PAE
3. Sistemet e Informacionit në Menaxhim - SIM	Vaso QANO	Prof.As.Dr.	Qendra Kërkimore e FE	60	PAE
4. Qeverisja e korporatave	Rezart DIBRA	Dr.	Dep. Menaxhimit	60	PAE
5. Drejtimi financiar i avancuar	F.BRAHIMI P.NDRECA	Prof.As.Dr.	Dep. Financës	60	PAK/PAE
7. Menaxhim operacional	Enriko CEKO	Dr.	Dep. Menaxhimit	60	PAE
8. Kontabilitet kosto drejtimi (Avancuar)	Flutra KALEMI Rezart DIBRA	Prof.Dr. Dr.	Dep. Financës Dep.Manaxhimit	75	PAK/PAE
9. Sjellja organizative	Enriko CEKO	Dr.	Dep. Menaxhimit	75	PAE
10. Auditimi & Shërb. sigurisë (SNA)	Pjeter NDRECA	Dr.	Dep. Financës	75	PAE
11. Ekonometri	Myslym OSMANI	Prof.Dr.	Dep. Financës	60	PAK
12. Administrim Publik	Remzi KECO	Prof.As.Dr.	Dep. Menaxhimit	60	PAK
13. Praktika profesionale	E.Ceko, E.Fita	Dr, Dr.Kand	Dep. Menaxhimit	75	PAE
14. Mbrojtja e diplomës	Stafi efektiv i Dep.	Dr.	Dep. Menaxhimit	300	PAE